



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 26.05.2023

Nr: 150

Ora: 12:00

**VENDIM**

**PËR MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 83, DATË 24.05.2023 TË DEPOZITUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA BALLI KOMBËTAR"**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 26.05.2023, me pjesëmarrjen e:

<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Anëtar</b>

Shqyrtoi çështjen me:

**ANKUES:** Partia "Balli Kombëtar"

**OBJEKT:**

1. Kundërshtimin e vendimit nr. 293, datë 18.05.2023 të KZAZ-së nr. 20, bashkia Krujë "Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të Bashkisë dhe për Këshillin e bashkisë në zonën zgjedhore bashkia Krujë, për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 14 maj 2023".
2. Pavlefshmërinë e rezultatit të QV nr. 1257, 1258, 1264, 1317 dhe 1316 për këshillin bashkiak Krujë.



3. Ndryshimin e Tabelës Përmbledhëse të rezultatit për Këshillin Bashkiak.

**BAZË LIGJORE:** Nenet 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

#### **VËREN:**

Subjekti zgjedhor “Partia Balli Kombëtar” ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 83 regj., datë 24.05.2023. Në seancën e datës 26.05.2023 KAS konstatoi se kjo kërkesë ankimore nuk i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, pasi është paraqitur me të meta, sepse i mungojnë provat bashkëlidhur, si dhe një përshkrim i detajuar i fakteve dhe rrethanave konkrete. Ndër të tjera, kërkesa ankimore nuk është paraqitur nga kryetari i subjektit zgjedhor PBK, ose nga përfaqësuesi i tij në KQZ.

Për këto arsye, në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “b”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore nuk duhet të kalohet për shqyrtim.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

#### **V E N D O S I:**

1. Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 83, datë 24.05.2023, të paraqitur nga subjekti zgjedhor “Partia Balli Kombëtar”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Bazuar në pikën 1, të nenit 145 të Kodit Zgjedhor mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 152 të tij.

<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Anëtar</b>